



### 3A Bashkim familjar tek një fëmija ose prindi

**Qëllimi:** Për fëmijët e mitur dhe prindërit të cilët dëshirojnë të jetojnë tek prindi/fëmija në Zvicër (me shtetësi Zvicerane ose leje qëndrim B,C,F).

**Ju lusim të mos vonoheni në ditën e terminit. Nëse arrini me vonesë, ju duhet të caktoni termin të ri.**

#### DOKUMENTET E NEVOJSHME

<input type="checkbox"/> 3 formularë të plotësuar dhe të nënshkruar si dhe 4 fotografi pasaporte.	<input type="checkbox"/> Dokumenti origjinal "Certifikatë e vendbanimit".
<input type="checkbox"/> Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit (pasaporta) si dhe 2 kopje.	<input type="checkbox"/> Dokumenti origjinal "Vërtetim nga arkivi" *
<input type="checkbox"/> 2 kopje të pasaportës të prindit ose fëmijës në Zvicër.	<input type="checkbox"/> Nëse keni ndryshuar emrin: Kopje e vërtetuar e aktgjykimit të ndryshimit të emrit lëshuar nga gjykata.*
<input type="checkbox"/> 2 kopje të leje qëndrimit të prindit ose fëmijës në Zvicër.	<input type="checkbox"/> Nëse jeni i/e shkurorëzuar: Kopje e vërtetuar e flete shkurorëzimit (me shënimin rreth plotfuqishmërisë) lëshuar nga gjykata. *
<input type="checkbox"/> Dokumenti origjinal "Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile".	<input type="checkbox"/> Nëse jeni i/e ve: Dokumenti origjinal "Certifikatë e vdekjes" i/e bashkëshortit/-es si dhe dokumenti origjinal "Certifikatë e gjendjes martesore".
<input type="checkbox"/> Dokumenti origjinal "Certifikatë e lindjes" lëshuar nga autoriteti kompetent ku ka ndodhur lindja.	<input type="checkbox"/> Nëse keni lindur jashtë martesës: Pranimi i atësisë lëshuar nga komuna përkatëse.*
<input type="checkbox"/> Formulari "Pyetje shtesë për bashkimin familjar" i plotësuar dhe i nënshkruar nga prindi ose fëmija në Zvicër.	<input type="checkbox"/> Dokumenti origjinal "Dëshmia që nuk jeni nën hetime penale dhe që nuk jeni i dënues për vepra penale" lëshuar nga Policia e Kosovës. Për te miturit prej moshës 14 vjeçare: dokumenti që personi nuk është nën hetime lëshohet nga Gjykata.*

#### Dokument shtesë për të miturit:

Nëse njëri prej prindërve jeton në Kosovë: Ai/ajo duhet të jetë prezent gjatë dorëzimit të kërkesës të fëmijës dhe ta japë pëlqimin me shkrim që fëmija të shkojë për të jetuar në Zvicër përgjithmonë (një deklaratë nga gjykata ose nga notari nuk pranohet). Prindi duhet të sjellë me vete letërnjoftim të vlefshëm.

#### INFORMATAT TË RENDËSISHME:

- Të gjitha dokumentet duhet të jenë me nga një kopje shtesë.
- \* Të gjitha vendimet të cilat janë në gjuhë lokale të Kosovës duhet të përkthehen në njërin prej gjuhëve zyrtare të Zvicrës.
- Gjithë dokumentet e gjendjes civile nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj.
- Personi i cili jeton në Zvicër duhet të informohet drejtpërdrejt me zyrën kompetente të migracionit për ecurinë e procedurës.
- Formularët si dhe informatat mund të merren falas nga Ambasada e Zvicrës.
- Ambasada nuk mund të përgjigjet në pyetjet në lidhje me statusin e dosjes në Zvicër.
- Për aplikim në Kosovë nuk është e nevojshme prania e personit i cili banon në Zvicër.
- Terminet caktohen në mënyre kronologjike dhe janë pa pagesë (nuk ka terminë me prioritet).
- Asnjë dokument nuk duhet të dërgohet në ambasadë përmes e-mail, postes, ose fax-it.
- Ju duhet t'i sillni dokumentet personalisht në ditën kur ju është caktuar termini.
- Dosjet e pakompletuara nuk pranohen.



### Si caktohet termini ?

- **Caktimi i terminimit:** Ju lusim ta kontaktoni ambasadën tonë përmes e-mailit për të caktuar termin: [pristina.visa@eda.admin.ch](mailto:pristina.visa@eda.admin.ch). Ju lutëm të bashkëngjitni **një kopje të skanuar dhe të lexueshme të pasaportës të personit që dëshiron të bëjë kërkesë për bashkim familjar**.
- **Marrja e vendimit:** Vendimi për vizë merret nga autoritetet kompetente në Zvicër. Fëmija / Prindi në Zvicër do të informohet me shkrim. Kur merrni vendimin, ju lusim që të vini me kopjen e vendimit dhe pasaportën tuaj prej të **hënës deri të premtën prej orës 8:00 deri në orën 9:45 në Ambasadë.**

### Vula apostile

Të gjitha dokumentet kosovare duhet ta kenë **vulën apostile**. Varësisht nga dokumenti qoftë nga Ministria e Punëve të Jashtme ose nga Ministria e Punëve të Brendshme.

#### Dokumentet e gjendjes civile:

Ministria e Punëve të Brendshme  
Sektori për Regjistrim dhe Status Civil  
Agjencioni për Regjistrimin e Qytetarëve  
Rruga Luan Haradinaj  
10000 Prishtinë

#### Aktgjykime gjyqësor ose vendime:

Ministria e Punëve të Jashtme  
Ndërtesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme  
Rruga Luan Haradinaj  
10000 Prishtinë

### Pagesa

- Falas për fëmijët nën moshën 21 vjeçare për bashkim familjar tek prindi me shtetësi zvicerane ose shtetësi të EU.
- Për fëmijët që dëshirojnë të bëjnë bashkim familjar tek prindërit me shtetësi kosovare:
  - 0 – 6 vjeç : Falas
  - 6 – 12 vjeç : 40 euro
  - +12 vjeç dhe të rriturit: 80 euro
- Për çdo pagesë që e bëni ju takon një fletëpagesë e nënshkruar.
- Pagesa duhet të bëhet në Euro.
- Pagesa bëhet vetëm tek sporteli brenda ambasadës (ndërtesa brenda rrethojave të zeza).
- Tarifat në lidhje me shërbimet konsullore janë llogaritur në bazë të rregullores RS 191.11.
- Tarifat në lidhje me aplikimet për vizë janë llogaritur në bazë të rregullores RS 142.209.
- Varësisht prej rastit: Pagesë shtesë administrate.
- Paratë e pagesës nuk kthehen (edhe në rast se viza refuzohet).
- Tarifat mund të ndryshojnë pa paralajmërim.

### Kujdes nga agjencitë

Personat që ofrojnë shërbimet e tyre jashtë rrethojave të zeza nuk kanë asnjë lidhje me ambasadën. Ambasada Zvicerane nuk bashkëpunon me ndonjë agjenci dhe stafi i ambasadës zvicerane nuk ka asnjë kontakt me agjencitë jashtë ndërtesës.

Keni parasysh se Ambasada Zvicerane ka të drejt:

- të kërkojë dokumente shtesë.
- ti dërgojë aplikimet për vendim apo miratim tek autoritetet në Zvicër.
- t'i thërrasë aplikuesit në bisedë ose intervistë.
- ta ndryshojë këtë rregullore pa një njoftim paraprak.